

Lokucionet numërore në gjuhën shqipe

Haredin Xhaferi*

Abstrakt

Lokucionet janë njësitë gjuhësore më pak të studiuara në gjuhësinë shqiptare dhe në atë të huaj. Në këtë shkrim do të bëhen objekt studimi lokucionet numërore, për të cilat është folur shumë pak. Trajtimi i tyre do të bëhet me metodën e analizës së fakteve gjuhësore, nxjerrë nga materiali i grumbulluar për këtë qëllim. Analiza do të bëhet në planin strukturor, pasi në planin semantik ato përbëjnë një grup të vetëm. Lokucionet numërore kanë strukturë të përbërë vetëm nga fjalë kuptimplota ose nga fjalë kuptimplota dhe nga fjalë jokuptimplota. Lokucionet dyfjalëshe përbëhen nga një numëror dhe njëra nga fjalët *mijë*, *million*, *miliard* etj. ose nga një emër i prejardhur nga një mbiemër prejnumëror. Lokucionet e formuara nga më shumë se dy fjalë përbëhen nga tri fjalë kuptimplota (dy numërorë dhe emri *presje* ose *pikë*) ose nga fjalë kuptimplota dhe nga fjalë jokuptimplota. Lidhja e elementeve të tyre është me bashkërenditje, me nënrenditje ose e përzier. Pavarësisht nga numri dhe nga forma morfologjike e elementeve, e gjithë struktura funksionon si një njësi e vetme dhe ka një kuptim tërësor, tregon sasi të caktuar frymorësh, sendesh etj. Lokucionet numërore janë më të shumta se numërorët dhe struktura e tyre është shumë e larmishme. Ato nuk i zëvendësojnë numërorët dhe nuk zëvendësohen prej tyre, prandaj janë të domosdoshme gjatë ligjërimit. Ky studim do t'i shërbejë dallimit të këtyre njësive në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera që i njohin lokucionet si njësi të veçanta gjuhësore.

Fjalë kyç: lokucion, fjalë kuptimplotë, fjalë jokuptimplotë, strukturë, vlerë semantike.

* Prof. Asoc. Dr. Haredin Xhaferi, Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër, Shqipëri.
Email: haredin.xhaferi@gmail.com

Hyrje

Sot ka një qëndrim të përbashkët për lokucionin si njësi gjuhësore e veçantë, e formuar nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve në një tërësi të vetme, që ka vlerën e një pjese të ligjëratës.

Lokucionet janë struktura të hapura dhe kanë vlerën semantike të një fjale. Ato përbëhen nga dy a më shumë elemente me lidhje të qëndrueshme. Në gjuhën shqipe përdoren lokucione me vlerën e çdo pjese të ligjëratës.

Lokucionet me vlerën e një pjese të pandryshueshme të ligjëratës, kryesisht lokucionet me vlerën e një ndajfoljeje, të një parafjale apo të një lidhëze janë më të studiuara. Nga lokucionet me vlerën e një pjese të ndryshueshme janë trajtuar shkurt vetëm lokucionet me vlerë. Sasia e frymorëve, e sendeve etj. mund të shprehet edhe nga struktura të formuara nga bashkimi i qëndrueshëm i dy a më shumë fjalëve. Këto struktura funksionojnë si një njësi e vetme dhe tregojnë një sasi të caktuar, duke qenë kështu semantikisht barazvlerëse me numërorët.

Numërorët dhe lokucionet numërore dallohen qartë nga struktura. Numërori ka strukturë të mbyllur, një nga kriteret kryesore të dallimit të fjalës nga togfjalëshi,¹⁴³ ndërsa lokucionet kanë strukturë togfjalëshe ose jotogfjalëshe. Numërorët kanë kuptimin e tyre kategorial, format e tyre morfologjike, kategoritë gramatikore, funksionet sintaksore dhe lidhjet gramatikore karakteristike, mbi bazën e të cilave edhe klasifikohen.¹⁴⁴ Lokucionet nuk i kanë këto veçori dhe kategori gramatikore. Numri i lokucioneve numërore është shumë herë më i madh se i numërorëve dhe përbërja e tyre strukturore është më shumë e larmishme.

¹⁴³ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011, f. 37.

¹⁴⁴ Fatmir Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f. 70.

Lokucionet numërore janë të përbëra vetëm nga fjalë kuptimplota ose nga fjalë kuptimplota dhe nga fjalë jokuptimplota, të cilat përgjithësisht janë shkuptimësuar. E gjithë struktura ka një kuptim të vetëm. Në sistemin e numrave këtyre njësisive u korrespondojnë numra të plotë natyralë me dy ose më shumë shifra, numra thyesorë ose numra dhjetorë (21; 101; 1001; 4/5; 3,6 etj.). Ndryshe nga shumë lokucione të grupeve të tjera, këto lokucione nuk kanë fjalë sinonime.¹⁴⁵

Studimet e posaçme për numërorët dhe për lokucionet numërore deri sot kanë munguar në literaturën tonë gjuhësore.

K. Kristoforidhi nuk i ka përmendur lokucionet as shprehjet numërore, megjithatë ka pasqyruar strukturat me element të dytë një nga fjalët *qind*, *mijë*, *milion* etj. dhe ato me lidhëzën *e*, duke i shkruar veç: *një qind*, *një mijë*, *një miliun*, *njëzet e një*, *një qind e një* etj.¹⁴⁶

A. Xanoni ka sjellë si shembuj për adjektivat numërorë strukturat: *njizet e një*, *njizet e dy*, *tridhet e një*, *nji milûû*, *dy milûû*.¹⁴⁷

I. D. Sheperi në një shënim ka quajtur numra të përzier edhe strukturat e tipit *njëzet e një*, *njëqind e gjashtëdhjetë e pesë*.¹⁴⁸

O. Myderrizi ka njohur si lokucione numërore: *dy fish*, *tre fish*, *dy herë*, *tri herë*, *dy nga dy*, *tre nga tre*, *nja dy*, *nja tre*.¹⁴⁹

Në veprat e autorëve të mëvonshëm është njohur dhe është përmendur termi "lokucion". K. Cipo e ka përmendur këtë term për një grup të veçantë numërorësh, të cilët i ka quajtur

¹⁴⁵ Fjalët barazvlerëse mungojë edhe për një pjesë të madhe të lokucioneve emërore. (Shih Haredin Xhaferi, "Note about locutions Nominative in Albanian Language," *5th International Conference on Social Sciences* (Vol. III), Prishtinë, 2015, f. 144).

¹⁴⁶ Shih Kostandin Kristoforidhi, *Vepra I*, Elbasan, 2001, f. 96 - 98.

¹⁴⁷ Anton Xanoni, *Gramatika Shqyp*, (Qi përdoret n' seminarë e n' mbësotitore t' sh' Françesk Saverit), Shkodër, 1909, f. 58.

¹⁴⁸ Ilo D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927, f. 51.

¹⁴⁹ Osman Myderrizi, *Gramatika e ré e shqipes, Fonologji e morfologji*, (Vëll. I), Për shkollat e mesme, Tiranë, 1944, f. 98.

numërorë shumëzorë: *një fish, dy fish* etj. Ai ka pasqyruar strukturat me lidhëzën *e pa* i ndarë si grup më vete.¹⁵⁰

Sh. Demiraj strukturat me lidhëzën *e*, si: *njëzet e një, njëzet e dy, tridhjetë e pesë, dyzet e shtatë* etj. dhe thyesat i ka quajtur lokucione.¹⁵¹ Këtë qëndrim ka mbajtur edhe B. Beci.¹⁵²

Në gramatikat e mëvonshme shprehjet numërore janë dalluar si një grup i veçantë numërorësh. Studiues të ndryshëm kanë përdorur termin “shprehje” në vend të termit “lokucion.” Termi “shprehje” ndeshet edhe në veprat themelore të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera.¹⁵³ Në gramatikat tona këto lokucione janë përfaqësuar nga ndërtimet që kanë element lidhëzën këpujore *e* si: *njëzet e një, njëzet e dy* etj. Dhe nga ndërtimet që kanë një numëror dhe një nga fjalët *qind, mijë, milion* etj.: *një mijë, një milion* etj.

Nga parashtrimi i mësipërm del se lokucionet me vlerë numërori nuk kanë qenë në vëmendjen e studiuesve për t’u trajtuar. Ato nuk janë njohur si njësi të veçanta leksikore dhe gramatikore. Për herë të parë i ka njohur dhe i ka pranuar M. Domi. Ai ka vënë në dukje se “Te numërorët themelore janë të shumta kategoritë e rastet kur numri shprehet prej bashkimit në një njësi të pandarshme të dy a më shumë fjalëve.” Pasi ka dhënë shembujt: *njëzet e tre, dy mijë, treqind e pesë, tridhjetë mijë e një, treqind e pesëdhjetë*, ka shtuar se “Të tilla bashkime s’ka si të mos quhen “lokucione numërore.”¹⁵⁴ Këtë qëndrim e ka përkrahur më pas edhe A. Spahiu.¹⁵⁵

¹⁵⁰ Shih Kristaq Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, f. 87 - 88.

¹⁵¹ Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 87 - 88.

¹⁵² Bahri Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1997, f. 66 - 67.

¹⁵³ Shih më tepër Haredin Xhaferi, *Locutions in Albanian language*, Saarbrücken, Germany, 2015, f. 9 - 11.

¹⁵⁴ Mahir Domi, “Disa çështje të lokucioneve,” *Studime filologjike 1*, Tiranë, 1985, f. 216.

¹⁵⁵ Agim Spahiu, “A përbëjnë lokucionet një mënyrë të veçantë të fjalëformimit?” *Gjuha jonë 1 - 4*, Tiranë, 2005, f. 163.

Klasifikimi

Lokucionet numërore klasifikohen sipas strukturës së tyre. Ato janë të përbëra nga dy ose më shumë fjalë.

1. Lokucionet me strukturë dyfjalëshe

Lokucionet e këtij tipi kanë element të parë një numëror, ndërsa element të dytë kanë një nga fjalët *mijë, milion, miliard* etj. ose një emër të prejardhur nga një mbiemër prejnumëror. Elementi i parë i këtyre lokucioneve nuk ndryshon gjatë përdorimit të lokucionit.¹⁵⁶

1. 1. *Lokucionet që kanë element të dytë një nga fjalët qind, mijë, milion, miliard* etj., tregojnë sasi të caktuar njësisish të plota. Në sistemin e numërimit këtyre njësive u korrespondojnë numra të përbërë nga dy elemente: nga një numër i ndryshëm nga zeroja dhe nga ky i fundit i përdorur disa herë (100, 2000, 3000 000 etj.). Një numër me strukturë të tillë i korrespondon edhe fjalës *dhjetë* (10), që sot konsiderohet numëror i thjeshtë.

Fjala *dhjetë* dhe fjalët *qind, mijë, milion, miliard* etj. kanë veçori e tipare të përbashkëta:

- Të gjitha këto fjalë tregojnë sasi të caktuar frymorësh ose sendesh.
- Kur marrin parashtesën - *ra* ose - *a*, dalin me përdorim përemëror: *dhjetra, qindra, mijëra, miliona* etj.
- Në bashkëvajtje me një numëror ato formojnë modele të njëjta strukturore, si: *pesëdhjetë (pesë dhjetë), pesëqind (pesë qind), pesë mijë, pesë milionë; gjashtëdhjetë (gjashtë*

¹⁵⁶ Shaban Demiraj e ka bërë këtë vërejtje vetëm për numëruesin e thyesave. (Demiraj, Vep. cit. f. 88.)

dhjetë), *gjashtëqind* (*gjashtë qind*), *gjashtë mijë*, *gjashtë milionë* etj.

Me gjithë afëritë, fjalët *qind*, *mijë*, *milion*, *miliard* etj. nuk janë klasifikuar në të njëjtën pjesë ligjërata me fjalën *dhjetë*. Në Gramatikën e Akademisë kjo e fundit është trajtuar si numëror, ndërsa fjalët e tjera janë quajtur emra, që funksionojnë vetëm në bashkëvajtje me një numër.¹⁵⁷ Në fjalorët e gjuhës shqipe fjala *dhjetë* është vendosur dy herë titull: si numëror dhe si emër. Fjalët e tjera janë pasqyruar vetëm si emra, me kategoritë e tij kryesore (gjini, numër, i pashquar / i shquar). Megjithatë, në kuptimin e parë janë shpjeguar si numërori *dhjetë*.

Midis këtyre fjalëve dhe fjalës *dhjetë* vihen re edhe dallime, si:

- Fjala *dhjetë* përdoret pa numërorin *një* (*dhjetë libra*, *dhjetë djem*, *dhjetë vajza* etj.), ndërsa fjalët e tjera, megjithëse janë pasqyruar veçan në fjalor, përdoren vetëm me këtë numëror (*njëqind*, *një mijë*, *një milion* etj.).¹⁵⁸
- Me fjalët *mijë*, *milion*, *miliard* etj. mund të përdoret një përemër pyetës a i pacaktuar në vend të numërorit. P. sh. *Sa mijë lekë kushton një dash në këto anë? Rojtari harxhonte disa milionë lekë për vreshtin çdo vit, sikur ta kishte të vetin.*
- Fjala *dhjetë* nuk ndryshon numrin kur lidhet me një numëror tjetër (*pesëdhjetë*, *gjashtëdhjetë*, *shtatëdhjetë* etj.), ndërsa fjalët e tjera (veç fjalës *qind*) ndryshojnë (*dy milionë*, *tre miliardë* etj.).
- Fjala *dhjetë* përdoret vetëm me numërorë të thjeshtë (*tridhjetë*, *pesëdhjetë* etj.), ndërsa fjalët e tjera (veç fjalës *qind*) përdoren edhe me numërorë të përngjitur a lokucione numërore (*njëzet mijë*, *dyqind e tridhjetë milionë* etj.).

¹⁵⁷ Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë, 2002, f. 207, 208.

¹⁵⁸ Në disa gjuhë të tjera, si frëngjisht, italisht etj. këto fjalë përdoren veçan dhe funksionojnë si numërorë: *cent* (një qind), *mille* (një mijë) etj.

Siç u vu në dukje më sipër, dallime vihen re edhe midis fjalës *qind* dhe fjalëve *mijë, milion, miliard* etj.

- Me fjalën *qind* nuk mund të përdoret një përemër në vend të numërorit.
- Fjala *qind* përdoret vetëm me numërorë të thjeshtë (*njëqind, dyqind ... nëntëqind*), sikurse fjala *dhjetë*, ndërsa fjalët e tjera përdoren edhe me numërorë të përngjitur a lokucione numërore (*tridhjetë mijë, njëqind e dyzet milionë* etj.).
- Fjalët *mijë, milion, miliard* etj. janë pasqyruar në fjalorë në të dy numrat. Në bashkëvjajtje me një numëror, ato e ndryshojnë numrin: *një milion - dy milionë, një miliard - dy miliardë* etj. Fjala *qind* është dhënë vetëm në formën e njëjësit. Kjo fjalë nuk pëson ndryshime kur shoqërohet nga numërorë të ndryshëm (*dy qind, tre qind, katër qind* etj.).
- Lokucionet që kanë në strukturë fjalën *qind*, dalin si element në struktura më të zgjeruara (*njëqind mijë, njëqind milionë* etj.), ndërsa lokucionet e formuara me fjalët *mijë, milion, miliard* etj. nuk janë elemente të ndonjë strukture të tillë.

Nga dallimet e mësipërme del se fjala *qind* duhet trajtuar si numëror, sikurse fjala *dhjetë*, me të cilën ka shumë afëri, ndërsa fjalët *mijë, milion* etj. duhen trajtuar si emra. Edhe në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe është vendosur që strukturat që kanë element të dytë këtë fjalë, të shkruhen si një fjalë e vetme (*njëqind, dyqind* etj.), sikurse strukturat që kanë element të dytë fjalën *dhjetë* (*shtatëdhjetë, tetëdhjetë* etj.). Për strukturat që kanë element një nga fjalët *mijë, milion, miliard* etj., është vendosur që të shkruhen ndaras, megjithëse në gramatika të ndryshme janë shkruar edhe si fjalë të përngjitura.¹⁵⁹ Për mendimin tonë, nuk ka ndonjë arsye që këto struktura të mos shkruhen si një fjalë e vetme, njëlloj si

¹⁵⁹ Shih *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe* (Vëll. II), Tiranë, 1976, f.

169. *Gramatika*, Vep. cit. f. 204, 205. Demiraj, Vep. cit. f. 86.

numërorët e përngjitur *tridhjetë, dyzet, pesëdhjetë* etj.¹⁶⁰ Gjatë shqiptimit ato ndihen më shumë si të tilla, me theksin kryesor tek elementi i dytë.

Lokucionet e këtij tipi përdoren në bashkëvajtje me çdo lloj emri dhe kryejnë funksionin e përcaktorit (të vetmin funksion që kryen numërori). P. sh. *Skënderbeu dhe këmbësoria e tij prej shtatë mijë luftëtarësh sulmuan në qendër. Apartamentin e kishte shitur pesëdhjetë milionë lekë.*

1.2. Te lokucionet që kanë element të dytë një emër prejmbiemëror, emri përdoret përgjithësisht në formën gramatikore të emërore - kallëzores së shquar¹⁶¹ njëjës, kur element i parë është numërori *një* dhe shumë, kur element i parë është një numëror tjetër (sikurse emrat *mijë, milion* etj.): *një e dyta, dy të tretat, tri të katërtat, gjashtë të dhjetat* etj. Emri nuk e ruan kuptimin themelor. Jashtë strukturës së lokucionit ai ka kuptimin “person, send etj. i emërtuar sipas rendit që ka në raport me një person a send tjetër”. Numërori në këto struktura është i patheksuar. Këtyre lokucioneve u korrespondojnë numrat e rregullt thyesorë (*një e dhjeta, dy të dhjetat, pesë të dhjetat* etj.) dhe numrat dhjetorë me numrin zero para presjes (0,1; 0,3 etj.) kur lexohen si thyesa (*një e dhjeta, tre të dhjetat* etj.).

Lokucionet e këtij tipi përdoren në bashkëvajtje me emrin e një njësie matëse (*kilogram, litër, metër, kilometër, hektar, orë* etj.) ose me disa emra të tjerë që emërtojnë sasi, si: *pjesë, copë* etj. dhe tregojnë sasi të caktuar të tyre. Emri shoqëruet përdoret në të pashquarën. Forma gramatikore e numrit të tij varet nga elementi i parë i lokucionit. Kur element i parë është numërori *një*, emri përdoret në njëjës (*një e dyta kilogram, një e treta metër, një e pesta pjesë* etj.). Në bashkëvajtje me një numëror tjetër, ai

¹⁶⁰ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f. 126, f. 131.

¹⁶¹ Osman Myderrizi i ka pasqyruar me formën gramatikore të së pashquarës. (Myderrizi, Vep. cit. f. 98.)

përdoret në shumës (*dy të tretat kilogramë, tri të katërtat kilometra, katër të pestat pjesë* etj.). P. sh. *Ena nxinte një të dytën kilogram ujë. Tri të katërtat kilometra rrugë ishin të asfaltuara. Katër të pestat pjesë të tokës kodrinore atë vit i kishin mbjellë me grurë.*

Kur këto lokucione ndiqen nga një emër në gjinore ose një përemër, kanë vlerën e një emri dhe kryejnë funksionet e tij. Në këtë rast emri në strukturën e tyre ndryshon sipas rasave. P. sh. *Tri të katërtat e pjesëmarrësve e ndiqnin bisedën në këmbë. Librat e tri të katërtave të nxënësve ishin të rinj.* Kur përdoren pas emrit, lokucionet e këtij tipi kanë vlerën e mbiemrit (sikurse numërorët). P. sh. *Thyesa një e dyta është e barabartë me thyesën dy të katërtat.*

2. Lokucionet e formuara nga më shumë se dy fjalë

Këto lokucione kanë përbërje strukturore shumë të larmishme. Ato përbëhen vetëm nga fjalë kuptimplota ose nga fjalë kuptimplota dhe fjalë jokuptimplota.

2.1. Lokucionet që kanë në strukturë vetëm fjalë kuptimplota, janë trigjymtyrëshe. Struktura e tyre është e përbërë nga dy numërorë dhe emri *presje* (ose *pikë*), i futur mes tyre. Të tri elementet përdoren të pandryshuara. Këto lokucione përdoren të shoqëruara nga një emër i një njësie matëse (*kg, m, kv, ha, orë* etj.). P. sh. *Gjerësia e kanalit ishte dy presje tetë metra. Rruga zgjati katër presje pesë orë.* Ato korrespondojnë me numrat dhjetorë zero *presje pesë* (zero *pikë pesë*), një *presje katër* (një *pikë katër*), dy *presje gjashtë* (dy *pikë gjashtë*) etj.

Lokucionet e këtij tipi përdoren për të treguar sasi të pjesëve të njëjësive të plota (zero *presje dy*, zero *presje tre* etj.) ose sasi të njëjësive të plota dhe të pjesëve të tyre (një *presje dy*, dy *presje katër* etj.). Gjatë përdorimit ato paraqiten si fjalë e përngjitur ose si lokucion. (njëpresjedy ose një *presje dy* etj.). Përgjithësisht ato

shqiptohen me theks tek elementi i fundit, njëlloj si fjalët e përngjitura dhe mund të trajtohen si të tilla.

2. 2. Lokucionet me elementet fjalë shënuese dhe fjalë shërbyese janë të shumta dhe mjaft të larmishme nga struktura. Kuptimisht ato tregojnë sasi të njësive të plota ose të njësive të plota dhe të pjesëve të tyre. Në strukturën e tyre fjalë shërbyese është lidhëza këpujore *e*. Lidhjet midis elementeve janë të ndryshme.

2. 2. 1. Në strukturat *njëzet e një deri nëntëdhjetë e nëntë* (përveç numërorëve të përngjitur, si: *tridhjetë, dyzet, pesëdhjetë* etj.) fjalët shënuese janë *me lidhje bashkërenditjeje*. Elementi i parë në çdo rast është numëror i përngjitur. Për këtë arsye, fjalët në këto struktura kanë rend të kundërt, krahasuar me strukturat me parafjalën *mbë* (*njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë* etj.). Elementi i fundit është numëror i parmë, i cili tregon sasinë që i shtohet asaj që tregon numërori i parë. Kuptimi i lokucionit është i ndryshëm nga kuptimi i secilit nga elementet.

Në periudha më të hershme te lokucionet e këtij tipi është përdorur edhe parafjala *pa* në vend të lidhëzës *e*: *pesë - dhjetë pa një, një qind pa një, një mijë pa një* në vend të *dyzet e nëntë, nëntë - dhjetë e nëntë, nëntë qind e nëntë - dhjetë e nëntë, dyzet pa dy, dyzet pa një, pesëdhjetë pa dy, pesëdhjetë pa një* etj.¹⁶²

Këto struktura kanë një kuptim leksikor të vetëm, tregojnë një sasi të caktuar frymorësh, sendesh etj., sikurse edhe strukturat me parafjalën *mbë* (*mbi*). Elementet e tyre përbërëse ndihen të shkrira në një njësi të vetme, kuptimi i së cilës del nga shuma e kuptimeve të elementeve përbërëse. Këtë veçori semantike e kanë përgjithësisht fjalët e përngjitura, për të cilat A. Kostallari ka shkruar se elementet e tyre përbëjnë ngjitjen e sintagmës. Kjo e fundit jep si rezultat një njësi të vetme, me vlerë semantike të barabartë me shumën e kuptimeve të gjymtyrëve të

¹⁶² Kristoforidhi, Vep. cit. f. 98.

bashkëngjitura, të cilat lidhen edhe me pjesëzat e ligjëratës.¹⁶³ As elementi *e* nuk i ruan më veçoritë e mëparshme gramatikore. Këtë dukuri e ka vënë në dukje edhe L. Buxheli kur shkruan se këto struktura po ndihen si të përngjitura, duke i humbur kjo zanore lidhjet kuptimore e funksionale me lidhëzën bashkërenditëse.¹⁶⁴

Strukturat në fjalë mund të trajtohen si njësi njëfjalëshe. Ky qëndrim është shprehur edhe gjatë diskutimeve për Drejtshkrimin e gjuhës shqipe.¹⁶⁵ Në gjuhën shqipe gjenden sot mjaft fjalë të përngjitura të këtij modeli.

2. 2. 2. Numër mjaft të madh përbëjnë lokucionet numërore me elemente të lidhura *me lidhje të përzier*. Brenda strukturës së këtyre lokucioneve fjalët janë me lidhje bashkërenditjeje dhe nënrenditjeje.

a. Një tip lokucionesh janë formuar nga një numëror dhe një lokucion numëror. Të tilla përmendim: *një e dy të dhjetat*, *dy e pesë të dhjetat* etj. Këto lokucione përdoren në dy forma: me lidhëzën *e* (*një e pesë të dhjetat*) ose me emrin *presje* apo *pikë* (*një presje* (*pikë*) *pesë*). Në të dy rastet ato shoqërohen nga emra të njësisive matëse në trajtën e pashquar. P. sh. *Një e pesë të dhjetat hektarë tokë i kishte mbuluar uji. Shishja plastike nxë një presje pesë litra qumësht*. Në formën e dytë këto lokucione përdoren rrallë. Semantikisht ato tregojnë njësi të plota dhe pjesë të këtyre njësisive.

b. Lokucionet *njëqind e një*, *një mijë e një*, *dy mijë e njëqind e një*, *një milion e tri mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë* etj. janë

¹⁶³ Androkli Kostallari, "Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe," *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, (Vëll. I), Tiranë, 1972, f. 85.

¹⁶⁴ Ludmilla Buxheli, "Çështje të shkrimit të fjalëve të përngjitura dhe të disa strukturave analitike," *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Tiranë, 2011, f. 357.

¹⁶⁵ Çelik Petriti, "Çështje të drejtshkrimit të numërorëve," *Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, (Vëll. II), Tiranë, 1973, f. 351.

formuar nga një a më shumë lokucione dhe një a më shumë numërorë të lidhur me bashkërenditje. Pavarësisht nga numri dhe nga forma morfologjike e elementeve, e gjithë struktura funksionon si një njësi e vetme dhe ka një kuptim tërësor. Elementet e togfjalëshave brenda lokucionit janë të lidhura më ngushtë dhe, siç u vu në dukje më sipër (II. 2. 2. 1.), ndihen si një fjalë.

Përfundime

Nga analiza e mësipërme del se në gjuhën shqipe janë të pranishme lokucionet numërore. Ato nuk zëvendësohen nga numërorët dhe nuk i zëvendësojnë ata. Përdorimi i tyre është i domosdoshëm gjatë ligjëritimit. Numri i lokucioneve numërore është shumë herë më i madh se numri i numërorëve. dhe përbërja e tyre strukturore është më shumë e larmishme.

Lokucionet numërore klasifikohen vetëm sipas kriterit strukturor. Ato përbëhen nga dy ose më shumë elemente. Sikurse numërorët, ato shërbejnë si tema fjalëformuese për mbiemrat me prejardhje numërore.

Mjaft prej këtyre lokucioneve sot mund të trajtohen si një fjalë e përngjitur. Lokucionet e formuara nga dy ose tri fjalë kanë mundësi më të mëdha njëfjalësimi, ndërsa ato që kanë në strukturë më shumë elemente, paraqesin vështirësi në shkrim dhe në shqiptim si njësi njëfjalëshe. Megjithatë, edhe elementet e tyre përdoren të bashkuara, kur këto lokucione janë në funksionin e temës fjalëformuese, duke formuar emra ose mbiemra: *njëzetedyshi, tridhjetegjashta, i njëqindetridhjeteshtatë, i njëmijetreqinenjëzetetë, njëmilionedyqindmijetreqindedyzetepetë etj.*¹⁶⁶

¹⁶⁶ Shih edhe *Drejtshkrimi*, Vep. cit. f. 127.

Bibliografia

Agalliu, Fatmir. *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: 1988.

Beci, Bahri. *Gramatika e gjuhës shqipe*. Tiranë: 1997.

Buxheli, Ludmilla. "Çështje të shkrimit të fjalëve të përngjitura dhe të disa strukturave analitike." *Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Tiranë: 2011.

Cipo, Kristaq. *Gramatika shqipe*. Tiranë: 1949

Demiraj, Shaban. *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*. Prishtinë: 1971.

Domi, Mahir. "Disa çështje të lokucioneve," *Studime filologjike* 1. Tiranë: 1985.

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë: 1973.

Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe Vëll. II. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: 1976.

Gramatika e gjuhës shqipe Vëll. I. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë: 2002.

Kostallari, Androkli. "Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe." *Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. Vëll. I. Tiranë: 1972.

Kristoforidhi, Kostandin. *Vepra I*. Elbasan: 2001.

Myderrizi, Oman. *Gramatika e ré e shqipes. Fonologji e morfologji*. Vëll. I. Për shkollat e mesme. Tiranë: 1944.

Petriti, Çelik. "Çështje të drejtshkrimit të numërorëve." *Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe*. Vëll. II. Tiranë: 1973.

Spahiu, Agim. "A përbëjnë lokucionet një mënyrë të veçantë të fjalëformimit?" *Gjuha jonë*. Vëll. 1 - 4, Tiranë: 2005, f. 163.

Sheperi, D. Ilo. *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*. Vlorë: 1927

Thomai, Jani. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: 2011.

Xanoni, Anton. *Gramatika Shqyp*. (Qi përdoret n' seminarë e n' mbështetore t' sh' Françesk Saverit). Shkodër: 1909.

Haredin Xhaferi

Xhaferi, Haredin. "Note about locutions Nominative in Albanian Language." *5th International Conference on Social Sciences*. Vol. III. Pristina: 2015.

Xhaferi, Haredin. *Locutions in Albanian language*. Scholars' Press. Saarbrücken, Germany: 2015. 50